

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Fillim Skoro, kryetar, Tonka Berishaj dhe Xhevdet Abazi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Eroll Gashi si procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarit M.T. Për shkak të veprave penale –vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par.1 pika 1.3 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprës penale –mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore-DKR në Prishtinë, ankesën e palës së dëmtuar K.M. si dhe ankesën e mbrojtësit të akuzuarit M.T., av. A.H. të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë,PKR.nr.238/18 të datës 12.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.11.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pa bazuara ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore-DKR në Prishtinë, ankesa e palës së dëmtuar K.M. si dhe ankesa e mbrojtësit të akuzuarit M.T., av. A.H., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.238/18 të datës 12.10.2018, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, PKR.nr.238/18 të datës 12.10.2018 i akuzuari M.T. është shpallur fajtor për shkak të veprave penale vrasje e rëndë në tentativë nga neni 179 par.1 pika 1.3 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprës penale –mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, ashtu që gjykata për veprën penale nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite e 8(tetë) muaj kurse për veprën penale nën pikën II të dispozitivit të aktgjykimit e ka gjykuar më dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, ashtu që konform nenit 80 par.1 dhe 2 nën par.2.2 të KPRK i ka shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite, të cilin dënim do ta vuaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Koha e kaluar në paraburgim nga data 24.05.2018 e tutje do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Gjykata të akuzuarit M.T. i ka shqiptuar edhe dënimin plotësues konfiskimin e mjetit-thikës, sipas vërtetimit mbi konfiskimin e gjëseneve të dt. 24.05.2018 si send i përdorur për kryerjen e veprës penale.

Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën aq sa do të llogaritet sipas shpenzimeve përfundimtare të gjykatës si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100 (njëqind) €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Është obliguar i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Pala e dëmtuar K.M. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Të akuzuarit M.T., me aktvendim të veçantë PKR.nr.238/18 të datës 12.10.2018 i është vazhduar masa e paraburgimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

-Prokurori i Prokurorisë Themelore-DKR në Prishtinë për shkak të vendimit mbi dënimin me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë, ashtu që të akuzuarit M.T. për veprat penale për të cilat është shpallur fajtor ti shqiptoj dënim më të lartë me burgim.

-Pala e dëmtuar K.T. për shkak të vendimit mbi dënimin me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Prishtinë ashtu që të akuzuarit ti shqiptoj dënim më të lartë me burgim.

-Mbrojtësi i të akuzuarit M.T., av. A.H. për shkak të vendimit mbi sanksionit penal me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe aktgjykimi të ndryshohet vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin dhe të akuzuarit ti shqiptoj një dënim më të butë.

Prokurori i Apelit me parashtresën PPA/I nr.516/18 të dt.14.11.2018, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e prokurorit si dhe ankesa e palës së dëmtuar dhe aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarve tu shqiptohen dënime më të larta kurse ankesa e mbrojtësit të akuzuarit M.T., av. A.H. të refuzohet si e pa bazuar.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK, Gjykata e Apelit, ka mbajtur seancën e kolegjit në të cilën ishin të pranishëm: Pala e dëmtuar K.M., përfaqësuesi i palës së dëmtuar, av. L.D., i akuzuari M.T. si dhe mbrojtësi i të akuzuarit M.T., av. A.H. kurse munguan Prokurori i Apelit si dhe përfaqësuesi i mbrojtësve të viktimave A.P. edhe pse ishin të njoftuar me rregull për kohën e mbajtjes së seancës, andaj seanca e kolegjit u mbajti në mungesë të tyre konform nenit 390 par. 4 të KPPK. Përfaqësuesi i palës së dëmtuar, av. L.D. mbetet pranë ankesës së ushtruar nga pala e

dëmtuar dhe propozon që ankesa të aprovohet si e bazuar. Pala e dëmtuar, K.M. mbetet në tërësi pranë ankesës së ushtruar me shkrim dhe nuk ka çfarë të shtojë. Mbrojtësi i të akuzuarit, av.A.H. pasi që bëri disa shqarime lidhur me pretendimet ankimore, mbetet në tërësi pranë ankesës I akuzuari M.T. e mbështet në tërësi mbrojtësin e tij dhe nuk ka çfarë të shtojë më shumë.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore të prokurorit, palës së dëmtuar si dhe ankesën e mbrojtësit të akuzuarit së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

-Ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore-DKR në Prishtinë si dhe ankesa e palës së dëmtuar K.M. janë të bazuara, kurse ankesa e mbrojtësit të akuzuarit nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtën e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare edhe në këtë aspekt konform nenit 394 par.1 të KPK-së dhe konstatoi se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat detyrimisht do të kishin kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë dhe trupi gjykues është pajtuar me një pohim të tillë nga neni 248 par.1 i KPPK-së, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimit ankimor.

Shkelja e ligjit penal

Pala e dëmtuar ka parashtruar ankesë për shkak të shkeljes së ligjit, mirëpo sipas nenit 381 par.3 të KPPK-së, pala e dëmtuar ka të drejtë ankese vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionet penale për veprat penale kundër jetës dhe trupit sikurse në rastin konkret, andaj duke u bazuar në dispozitën e lartë cekur ankesa për shkak të shkeljes së ligjit penal nga ana e palës së dëmtuar nuk është e lejuar.

Vendimi mbi dënimin

Në ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore-DKR në Prishtinë pretendohet se gjykata shkallës së parë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, e ka përsëritur vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese, ashtu që rrethanat lehtësuese i ka vlerësuar më shumë, kurse rrethanat rënduese konsideron se nuk i ka vlerësuar mjaftueshëm. Pasi që i sqaron rrethanat rënduese dhe lehtësuese të cilat i ka marrë për bazë gjykata e shkallës së parë, prokurori pretendon se kanë ekzistuar rrethanat të tjera rënduese të cilat gjykata e shkallës së parë është dashur ti merr për bazë siç janë: dashjen e të akuzuarit për ta privuar nga jeta të dëmtuarën bashkëshorten e tij K.M., pastaj kërcënimet se do ta vriste të dëmtuarën, faktin që të dëmtuarën e ka goditur 23 herë me thikë në dorën e majtë, e që në momentin e shkakimit kanë qenë të rrezikshme për jetën e të dëmtuarës, andaj sipas tij nëse kryesve të veprave penale të kësaj natyre

u shqiptohen dënime të buta dhe jo adekuate, nuk do të mund të luftohen me efikasitet veprat penale të kësaj natyre dhe nuk do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPRK-së.

Ankesë ka parashtruar edhe pala e dëmtuar për shkak vendimit mbi dënimin ku pasi sqaron rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat gjykata e shkallës së parë i ka marrë për bazë kur i ka shqiptuar dënimin të akuzuarit, mirëpo pala e dëmtuar pretendon se ky vlerësim i rrethanave është në kundërshtim me ligjin sepse gjykata ka vlerësuar sjelljen e të pandehurit pas kryerjes së veprës penale pa i shpjeguar arsyet se pse e ka bërë një vlerësim të tillë, e në këtë rast nuk ka prova për sjelljen e të akuzuarit të cilat do të ndikonin në zbutjen e dënimit ndaj tij. Në ankesë pala e dëmtuar po ashtu pretendon se i akuzuari asnjëherë nuk ka shprehur keqardhje për verëpn penale të kryer dhe si palë e dëmtuar ka mëdyshje nëse me këto dënime të shqiptuara do të arrihet qëllimi i dënimit që i akuzuari në të ardhmen të mos kryej vepra të tjera penale.

Për shkak të vendimit mbi dënimin ankesë ka parashtruar është mbrojtësi i të akuzuarit, i cili pretendon se dënimi i shqiptuar është tejet i rëndë si dhe jo në përputhje me qëllimin e dënimit nga neni 41 të KPRK-së e kjo për faktin se vetëm formalisht gjykata është thirrur në arsyetim të saj se ekzistojnë rrethanat lehtësuese mirëpo sipas mbrojtës këto rrethana nuk i ka zbatuar dhe nuk i ka marrë parasysh sepse po ta kishte bërë një gjë të tillë atëherë të akuzuarit do të shqiptohej një dënim më i butë sesa dënimi i shqiptuar. Në ankesë mbrojtja pretendon se dënimi prej 3 vite e 8 muaj për shkak të veprës penale vrasje e rëndë në tentativë është tepër i rëndë dhe jo në përputhje me praktikën gjyqësore sepse në raste të tilla kryesve iu shqiptohen dënime më të buta e kjo edhe në raste më të rënda kur vepra penal kryhet me armë zjarri në vende publike. Po ashtu edhe për veprën penale tjetër për të cilën është dënuar i akuzuari mbrojtja pretendon se është shqiptuar dënim i rëndë sepse në raste të tilla zakonisht gjykatat shqiptojnë dënim me gjobë ose dënim të kushtëzuar duke konsideruar se ky dënim si i tillë është i pa drejtë dhe të akuzuarit ky dënim duhet të zbutet.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të akuzuarit i ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit konform nenit 73 të KPRK-së, që kanë ndikuar në ashpërsimin ose në zbutjen e dënimit. Si rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka marrë: se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprat penale, moshën e re të akuzuarit, keqardhjen për veprat e kryera, pendimin për kryerjen e veprave penale, se i njëjti vetë e ka lajmëruar policinë dhe është dorëzuar, gjendja ekonomike se është i pa punë, është baba i dy fëmijëve si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tjera penale. Si rrethana rënduese ka gjetur shkallës ë lartë të pjesëmarrjes së të akuzuarit në kryerjen e veprave penale, mirëpo duke u bazuar nga rrethanat lehtësuese e siç është si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimi i fajësisë, gjykata i ka aplikuar dispozitat e nenit 74,75 dhe 76 të KPRK-së për zbutjen e dënimit.

Vlerësimin e këtillë të rrethanave për matjen e dënimit, si të drejtë e aprovon edhe Gjykata e Apelit, e cila vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në përputhje me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të saj dhe është në funksion të preventivës së

përgjithshme, posaçërisht asaj të posaçme dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPRK-së, Për një dënim me të ashpër, siç pretendon Prokurori dhe pala e dëmtuar apo për një dënim më të butë siç pretendon mbrojtja, nuk janë plotësuar kushtet ligjore, aq më parë kur me ankesa nuk theksohen rrethana të tilla që do të arsyetonin dënime siç kanë propozuar palët. Në fakt rrethanat rënduese të përmendura në ankesën e prokurorit –dashja për e të akuzuarit për ta privuar nga jeta të dëmtuarën bashkëshorten e tij K.M., pastaj kërcënimet se do ta vriste të dëmtuarën paraqesin elementet e veprës penale andaj si të tilla nuk e kanë cilësinë e rrethanave rënduese.

Përkritazi me pretendimi i të dëmtuarës se i akuzuari e ka pranuar fajësinë vetëm për të përfituar lidhur me vendimin për dënimin kjo Gjykatë vlerëson se është e drejtë ligjore e akuzuarit që në procedurën penale të deklarohet lidhur me fajësinë (në rastin konkret neni 246 të KPPK) pastaj gjykata vendos se a do ta aprovoj ose mos aprovojë pranimin e fajësisë (neni 248 të KPPK), kurse sipas dispozitës së nenit 75 par. 1 nën par. 1.3 të KPRK në këto raste mund ta zbus dënimin nën minimumin e përcaktuar me Kodin Penal për veprën penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor.

Nga arsyet e cekura më lartë ankesat u refuzuan si të pa bazuara.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të dispozitës së nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR 543/2018 datë 22.11.2018

Procesmbajtës,

Eroll Gashi

Anëtarët e kolegjit,

Tonka Berishaj

Xhevdet Abazi

Kryetari i kolegjit,

Fillim Skoro